

VENDIM
Nr.113, datë 17.2.2007

**PËR ORGANIZIMIN, FUNKSIONIMIN, PËRBËRJEN DHE PËRCAKTIMIN E MASËS
SË SHPËRBLIMIT TË ANËTARËVE TË KOMITETIT NDËRSEKTORIAL, PËR
Mbrojtjen nga Produktet e Duhanit (KNMSHPD)¹**

(Ndryshuar me VKM nr.736, datë 8.12.2017)

(I përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 17 të ligjit nr.9636, datë 6.11.2006 “Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit”, me propozimin e *Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale*, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ngritjen e Komitetit Ndërsektorial për Mbrojtjen nga Produktet e Duhanit (KNMSHPD), me kryetar ministrin e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe me këtë përbërje:

- a) Zëvendësministri i Financave dhe Ekonomisë anëtar;*
- b) Zëvendësministri i Arsimit, Sportit dhe Rinisë anëtar;*
- c) Zëvendësministri i Brendshëm anëtar;*
- d) Kryetari i Këshillit Kombëtar i Radios dhe Televizionit Publik Shqiptar anëtar;*
- ç) Zëvendësministri i Turizmit dhe Mjedisit anëtar;*
- dh) Drejtori i Institutit të Shëndetit Publik anëtar;*
- e) Kryeinspektori Sanitar Shtetëror anëtar;*
- ë) Drejtori i Policisë Bashkiake Tiranë anëtar;*

Funksionet e sekretarit të KNMSHPD-së të kryhen nga Drejtori i Institutit të Shëndetit Publik.

2. KNMSHPD-ja përgjigjet për detyrat e ngarkuara në nenet 4 dhe 18 të ligjit nr.9363, datë 6.11.2006 “Për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit”.

3. KNMSHPD-ja mblidhet jo më pak se 4 herë në vit dhe thirret nga kryetari, i cili, 5 ditë para mbledhjes, u njofton anëtarëve rendin e ditës dhe u dërgon atyre materialet përkatëse.

4. Mbledhjet janë të vlefshme kur marrin pjesë jo më pak se gjysma e anëtarëve dhe vendimet merren me shumicë votash. Në rast barazimi të votave “pro” dhe “kundër”, vota e kryetarit është përcaktuese.

5. Anëtarët e KNMSHPD-së, caktojnë, në çdo mbledhje, me shumicë votash, rendin e ditës së mbledhjes së ardheshme.

6. Shpërblimi për pjesëmarrësit, për çdo mbledhje, bëhet sipas vendimit nr. 418, datë 27.6.2012, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e masës së shpërblimit të anëtarëve të këshillave, bordeve ose komisioneve të njëjësive të qeverisjes qendrore”, të ndryshuar.

7. Efektet financiare të përballohen nga buxheti i miratuar për Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

8. Krahas detyrave të përcaktuara në ligjin në fuqi, KNMSHPD-ja përcakton formën dhe tekstin e mesazheve në çdo njësi pakete apo paketimi të produkteve të duhanit. Përditësimi i tyre bëhet, minimalisht, çdo 2 vjet.

9. Sekretari i KNMSHPD-së mban procesverbalin e mbledhjes, i cili nënshkruhet nga kryetari dhe sekretari.

10. Ngarkohet Ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për zbatimin e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
SALI BERISHA

¹ VKM nr.113 datë 17.2.2007 është botuar në Ekstra nr.56, korrik 2010.
VKM nr.736, datë 8.12.2017 është botuar në Fletoren Zyrtare nr.223, 20 dhjetor 2017.